

## KOMUNIKATË PËR SHTYP

### Pjesëmarrja e publikut në vendim-marrje, qenësore për demokracinë, thotë shefi i Misionit të OSBE-së

**PRISHTINË, 15 shtator 2012** – Shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Ambasadori Werner Almhofer, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë, theksoi rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut dhe transparencës në vendim-marrje politike.

“Institucionet e nivelit qendror dhe lokal duhet të kërkojnë pjesëmarrje më aktive të publikut kur përpilohen politikat që e prekin atë. Kjo është thelbësore për demokracinë dhe për qëndrueshmërinë e institucioneve demokratike”, tha ai.

“Veçanërisht për të rinjtë, gratë dhe për anëtarët më të cënueshëm të shoqërisë, është e rëndësishme që të thonë fjalën e tyre në vendim-marrje”, shtoi Almhofer, duke vënë në pah që OSBE ka mbështetur Kuvendin e Kosovës dhe kuvendet komunale në nxitjen e shtrirjes së tyre në terren dhe ngritjen e pjesëmarrjes së publikut.

“Komisionet komunale gjithnjë e më shumë mbajnë aktivitete në terren dhe dëgjime publike. OSBE ka mbështetur sidomos grupet e grave që të bëhen më shumë aktive dhe kanë ndihmuar këshillat për veprim rinor që të zhvillojnë kapacitetet e nevojshme që të jenë më shumë pjesëmarrës. Ne gjithashtu kemi vërejtur një përmirësim të dukshëm të institucioneve në inkurajimin e përfshirjes së publikut në prioritetet e buxhetit”.

Almhofer ka theksuar transparencën si një parakusht për institucionet demokratike që të gëzojnë besimin e publikut. “Shoqëria civile dhe mediat duhet të jenë në gjendje të kenë qasje në informim nga institucionet me qëllim që të mbajnë zyratë përgjegjës. OSBE së fundi ka mbështetur zhvillimin e bazës së të dhënave të shoqërisë civile në ueb faqen e Kuvendit, duke iu mundësuar OJQ-ve që të marrin rregullisht të dhënat nga Kuvendi dhe të kenë qasje në publikime. Institucionet e Kosovës duhet të vazhdojnë të përmirësojnë qasjen në informim për mediat”.

Misioni i OSBE-së në Kosovë është i mandatuar për mbështetje në ndërtimin institucioneve demokratike, promovimin e të drejtave të njeriut dhe ndihmë në zhvillimin e sektorit të sigurisë publike.